REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJË

Nr. 543 **Prot.** **Lushnjë, më** 14/01/2026

R E L A C I O N

KËSHILLIT BASHKIAK
PËR MIRATIMIN E MARRJES ME QIRA TË NJË AMBIENTI TË PËRKOHSHËM PËR NJËSINË ADMINISTRATIVE KRUTJE

Të nderuar zonja dhe zotërinj këshilltarë!

Në buxhetin e vitit 2025 të Bashkisë është parashikuar investimi për "Rikonstruksion i godinës së Njësisë Administrative Krutje". Në zbatim të procedurave ligjore, kontrata për realizimin e këtij investimi është lidhur në datë 29.12.2025 me nr.11415 Prot., ndërkohë që zbatimi i punimeve do të realizohet gjatë vitit 2026.

Gjatë periudhës së zbatimit të punimeve për rikonstruksionin e godinës, ambientet aktuale të Njësisë Administrative Krutje nuk mund të përdoren për ushtrimin e aktivitetit normal administrativ, pasi godina do të jetë jashtë funksionit. Për të garantuar funksionimin normal të Njësisë Administrative dhe vijimësinë e shërbimeve ndaj qytetarëve është e domosdoshme marrja me qira e një ambienti të përkohshëm.

KRYETAR I BASHKISË
Eriselda SEFA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA LUSHNJË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJË

Nr. 543/1 **Prot.** **Lushnjë, më** 14/01/**2026**

PROJEKT-VENDIM

NR. 08 **DATË** 14 /01 /**2026**

"PËR MIRATIMIN E MARRJES ME QIRA TË NJË AMBIENTI TË PËRKOHSHËM PËR NJËSINË ADMINISTRATIVE KRUTJE"

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës___/___/2026 pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga administrata e Bashkisë, në mbështetje të nenit 9 pika 1.1 shkronja "b", pika 1.6 shkronja "a", nenit 64, shkronja "b", të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar,si edhe nenet 801–822 të Ligjit Nr.7850, datë 29.7.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar,

PROPOZOJMË:

1. Miratimin e marrjes me qira të përkohshme të një godine për administratën e Njësisë Administrative Krutje deri në përfundim të rikonstruksionit të plotë të godinës së Njësisë Administrative.
2. Vlera e qirasë është deri në vlerën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administratori i Njësisë Administrative Krutje për lidhjen e kontratës së qirasë dhe Drejtoria e Finacës dhe Buxhetit.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes.

DREJTORIA JURIDIKE

Bedri Hida

DREJTORIA E FINANCË BUXHETIT

Ervisa Çuko

KRYETARI I BASHKISË

ERISELDA SEFA